

KONTRATË

SHITJE KUOTASH

(Transferimi i Kuotave)

Në Tiranë, sot më 21/12/2018, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

SHITËSIT:

- **Daniele Grillo**, shtetas italian, banues në Rome, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me Nr personal. YA3013418;
- **Gerardo Spaltro**, shtetas italian, banues në Rome, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me Nr personal. AX2363558.

Më poshtë te quajtur "Shitësi",

BLERËSI:

- **Klevisa Rama**, shtetase shqiptare, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartes së identitetit me Nr. J05804061V

Më poshtë i quajtur "Blerësi",

Në përputhje me Nenet e Statutit të Shoqërisë dhe në mbështetje të Ligjit shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, date 14.04.2008, i ndryshuar, palët bien dakort si më poshtë:

Transferimi nepermjet shitjes i kuotave të ortakut Z. Daniele Grillo, i cili sipas statutit posedon 50% të kuotave të shoqërisë "Bullion" Shpk, në favor të Klevisa Rama.

Transferimi nepermjet shitjes i kuotave të ortakut Z. Gerardo Spaltro, i cili sipas statutit posedon 50% të kuotave të shoqërisë "Bullion" Shpk, në favor të Klevisa Rama.

Shitësit largohen përfundimisht si ortak të Shoqërinë "Bullion" Shpk.

Shitësit deklarojnë se kanë marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën nominale të kuotave 100 leke, nga ku Daniele Grillo ka marrë vlerën nominale të kuotave 50 leke, dhe Gerardo Spaltro ka marrë vlerën nominale të kuotave 50 leke.

Blerësi pranon pronësinë e këtyre Kuotave në shitje, duke njohur gjëndjen e Shoqërisë dhe bie dakort me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i këtyre Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.

Shitësi dhe Blerësi bien dakort të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të këtyre Kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Regjistrimit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Me nënshkrimin e kësaj akt-marreveshjeje, palët ndryshojnë dhe bëhen si më poshtë:

Klevisa Rama bëhet ortakë e vetme e shoqërisë, me zotërim të 100% të kapitalit të shoqërisë "Bullion" Shpk.

Kjo Marrëveshjeje u hartua në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar.

Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht.

SHITËSI

SHITËSI

BLERËSI

DANIELE GRILLO

GERARDO SPALTRO

KLEVISA RAMA

